

VENDIM
Nr. 67, datë 17.5.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR “PËRMBAJTJEN E PROGRAMEVE
TË FORMIMIT VAZHDI, SHËRBIMET LEHTËSUESE TË LEJUARA, SI DHE
PËR PROCEDURËN E PAJISJES ME LEJE PËR NDJEKJEN E TRAJNIMEVE”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 5, pika 6, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 159, pika 2, germa “e”, dhe 189, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të grupit të punës, ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit nr. 183, datë 30.12.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullore për përmbajtjen e programeve të formimit vazhdi, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe për procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve”.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot, më 17.5.2024.

KRYETAR
Alfred Balla

RREGULLORE
**PËR PËRMBAJTJEN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT VAZHDI, SHËRBIMET
LEHTËSUESE TË LEJUARA, SI DHE PAJISJEN ME LEJE PËR NDJEKJEN E
TRAJNIMEVE**

KREU I
PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara për përshtatshmërinë dhe përmbajtjen e programeve të formimit vazhdi të prokurorëve, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe pajisjen me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “*Ligji për statusin*” është ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. “*Ligji për qeverisjen*” është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. “*Këshilli*” është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
4. “*Komisioni*” është Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

5. *“Formim vazhdues”* ka të njëjtin kuptim me togfjalëshin *“trajnim vazhdues”*, sipas nenit 272, të ligjit për qeverisjen.

6. *“Programe trajnimi të përshtatshme për funksionin”* do të kuptojmë programin e formimit vazhdues, i cili përmban tema trajnimi që i shërbejnë plotësimit dhe rritjes profesionale të magjistratëve prokurorë në ushtrimin e detyrës që ofrohen nga Shkolla e Magjistraturës ose nga institucione trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

7. *“Institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar i njohur nga Këshilli”* është çdo institucion ose organizatë, vendëse ose e huaj me reputacion të mirënjohur, e specializuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e vlerave demokratike apo zbatimin e ligjit që ofron trajnim në këto fusha.

8. *“Shërbime lehtësuese të lejuara”* janë shërbimet e ofruara nga prokurorët kur ata angazhohen si ekspertë, lehtësues apo moderatorë në trajnimet e programit të formimit vazhdues.

9. *“Ekspert, moderator, lehtësues ose specialist”* konsiderohet prokurori që angazhohet me këto detyra në programin e formimit vazhdues sipas parashikimeve në Rregulloren e brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

10. *“Njësia e Trajnimit”* është struktura mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë pranë Këshillit.

Neni 3 Subjektet

Subjekt i kësaj Rregulloreje janë:

1. Prokurorët e Republikës së Shqipërisë, në të gjitha nivelet, që ndjekin programin e trajnimit të formimit vazhdues të ofruar nga Shkolla e Magjistraturës apo nga çdo institucion dhe organizatave në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli;

2. Prokurorët që angazhohen si ekspertë, trajnerë, specialistë, moderatorë ose lehtësues në realizimin e trajnimit e programit të formimit vazhdues, të realizuara nga Shkolla e Magjistraturës apo nga institucione dhe organizata trajnimi, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

KREU II PROGRAMI I FORMIMIT VAZHDUES

Neni 4 Programi i formimit vazhdues

1. Programi i formimit vazhdues hartohet nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Këshillin bazuar në analizën e nevojave për trajnim të prokurorëve, zhvillimin e kurrikulave dhe programeve trajnuese.

2. Pjesë e formimit vazhdues janë edhe trajnimet që organizohen nga institucione dhe organizata trajnimi, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli, të përshtatshme me nevojat për trajnim të përcaktuara në kurrikulën e Shkollës së Magjistraturës dhe të evidentuara nga Këshilli, duke përfshirë sugjerimet e ardhura nga Njësia e Trajnimit.

Neni 5 Detyrat e Këshillit

Këshilli bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe organizatat e tjera të njohura nga Këshilli, në lidhje me realizimin e programit të formimit vazhdues të prokurorëve dhe kryen detyrat e mëposhtme:

1. Bashkëpunon dhe këshillon Shkollën e Magjistraturës, si dhe institucionet e trajnimit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohura nga Këshilli, në lidhje me përmbajtjen e programit tematik dhe organizimin e aktiviteteve trajnuese të programit të formimit vazhdues për prokurorët dhe miraton programet dhe organizimin e aktiviteteve trajnuese përkatëse mbi bazën e propozimeve të njësishë së trajnimit.

2. Miraton dhe pajis me leje, në fillim të vitit akademik, listat e pjesëmarrësve të prokurorëve në formimin vazhdues, të propozuara nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës, për një periudhë të paktën 1-vjeçare, por jo më shumë se tre vjet dhe ia dërgon Shkollës së Magjistraturës, sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje.

3. Përditëson gjatë vitit akademik, me kërkesë të Shkollës së Magjistraturës ose me iniciativën e vet ose kërkesa të prokurorëve, programin tematik dhe listat e pjesëmarrësve në formimin vazhdues, me qëllim që në raste të veçanta dhe përjashtimore, të mos pengojë procesin e trajnimit, të plotësojë nevojat e prokurorëve për trajnim të lidhura me ndryshime të legjislacionit dhe probleme të praktikës.

4. Vendos, mbi kërkesat e prokurorëve, për pjesëmarrjen e tyre në formimin vazhdues në trajnime të organizuara nga institucione trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohura nga Këshilli.

5. Këshillon Shkollën e Magjistraturës rreth prokurorëve që mund të jenë ekspertë, trajnerë, specialistë, moderatorë ose lehtësues në realizimin e trajnimeve të programit të formimit vazhdues. Për këtë, Këshilli, vlerëson përshtatshmërinë e prokurorëve me temën dhe rolin e propozuar dhe, sipas rastit miraton, kërkesat e paraqitura prej tyre për veprimtari jashtë funksionit.

6. Monitoron dhe raporton publikisht në lidhje me efektivitetin e trajnimeve.

7. I kërkon Shkollës së Magjistraturës informacion dhe të dhëna për pjesëmarrjen e prokurorit në formimin vazhdues të renditura në nenin 50 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, të tilla si, por pa u kufizuar, numrin e trajnimeve në të cilat prokurori është ftuar, temën dhe kohëzgjatjen e trajnimeve, nivelin e pjesëmarrjes së magjistratit.

8. Përmes Njësishë së Trajnimit përditëson regjistrat e trajnimeve të kryera me Shkollën e Magjistraturës me ato të ofruara dhe certifikuara nga organizata të tjera kombëtare e ndërkombëtare të njohura nga Këshilli.

9. Kryen çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj dhe sipas kësaj Rregulloreje në fushën e formimit vazhdues të prokurorëve.

KREU III

PJESËMARRJA E PROKURORIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT VAZHDI

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit

1. Prokurori, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues në trajnime që organizohen nga Shkolla e Magjistraturës ose nga institucione dhe organizata të tjera, të njohura nga Këshilli.

2. Prokurori respekton kërkesa ligjore dhe ato të nenit 7 të kësaj Rregulloreje lidhur me periudhën e trajnimit dhe nuk tejkalon afatet maksimale të lejuara.

3. Prokurori ka të drejtë të propozojë tema të ndryshme dhe të bashkëpunojë me Këshillin dhe Shkollën e Magjistraturës, me qëllim përmirësimin dhe pasurimin e programit të formimit vazhdues dhe frekuentimin e këtij programi sipas kërkesave ligjore.

4. Prokurori përmbush detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues, vetëm në ato raste kur programet apo temat e trajnimit janë:

- a) të përshtatshme për funksionin e tij;
- b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, i njohur nga Këshilli.

5. Prokurori merr çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legislative dhe të jurisprudencës përmes pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues.

6. Prokurorët që marrin pjesë në formimin vazhdues, pajisen me certifikatë, të lëshuar nga drejtori i Shkollës, si dhe nga institucione trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohura nga Këshilli, ku vendoset edhe logoja e Këshillit. Një kopje e certifikatës së pjesëmarrjes vendoset në dosjen personale të prokurorit që mbahet në Këshill.

Neni 7

Periudha e programit të formimit vazhdues

1. Periudha e programit të formimit vazhdues është:

- a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;
- b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë viteve.

2. Ditët e trajnimit llogariten si pjesë e periudhës së formimit vazhdues në rastin kur trajnimi organizohet nga Shkolla e Magjistraturës ose kur trajnimi organizohet nga institucione dhe organizata, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli, brenda apo jashtë vendit.

3. Këshilli bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e ditëve për trajnim përpara fillimit të çdo viti akademik apo edhe gjatë vitit, duke pasur parasysh që mos tejkalohen afatet maksimale të lejuara për afatin pesëvjeçar.

Neni 8

Pajisja me leje për formimin vazhdues

1. Këshilli miraton pjesëmarrjen e prokurorëve në formimin vazhdues, sipas programit të përcaktuar të formimit vazhdues dhe ia dërgon Shkollës së Magjistraturës në fillim të vitit akademik.

2. Lista emërore e prokurorëve e shoqëruar nga programi i formimit vazhdues që dërgohet nga Shkolla e Magjistraturës shqyrtohet nga Komisioni dhe miratohet në mbledhjen më të afërt të Këshillit.

3. Me kërkesë të Shkollës së Magjistraturës ose me iniciativën e vet, për raste të veçanta dhe përjashtimore nga pika 1 e këtij neni, Këshilli përditëson listën e pjesëmarrësve në formimin vazhdues edhe gjatë vitit akademik. Ky bashkëpunim synon:

- a) të mos pengohet procesi i trajnimit në raste të mungesave objektive të prokurorëve të përzgjedhur në trajnim;
- b) të plotësohen nevojat e prokurorëve për trajnim të lidhura me ndryshime të legjislacionit dhe probleme të praktikës;
- c) për shkaqe të tjera të vlerësuara nga institucionet përkatëse.

Në këtë rast, Shkolla e Magjistraturës vë në dijeni Këshillin për miratimin/përditësimin e listave të reja.

4. Këshilli miraton pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime profesionale, si pjesë e formimit vazhdues, edhe në rastin kur këto trajnime organizohen nga institucione dhe organizata trajnimi, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Kërkesa apo propozimi për të marrë pjesë në këto trajnime shqyrtohet nga Komisioni dhe miratohet në mbledhjen më të afërt të Këshillit.

5. Kërkesa apo propozimi drejtuar Këshillit, nga organizata në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, duhet të përmbajë një letër interesi, përmbajtjen e detajuar dhe temat e trajnimit, kohëzgjatjen, vendin e trajnimit, CV-të e ekspertëve, mënyrën e mbulimit të shpenzimeve etj.

6. Nëse e vlerëson të nevojshme, Komisioni udhëzon njësinë mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë për të kërkuar çdo dokument të nevojshëm, që vërteton ekspertizën profesionale të institucionit dhe të organizatës trajnuese dhe të dhëna shtesë lidhur me trajnimin.

7. Në shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me leje, Komisioni mban parasysh respektimin e kufijve të pjesëmarrjes apo të angazhimit, sipas ligjit dhe kësaj Rregulloreje.

8. Vendimi i Këshillit, për miratimin e pjesëmarrjen e prokurorëve në programin e formimit vazhdues i njoftohet menjëherë Shkollës së Magjistraturës, zyrës së prokurorisë ku është i emëruar prokurori dhe vetë prokurorit pjesëmarrës.

Neni 9

Shpenzimet për pjesëmarrje në aktivitete trajnuese

1. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për ndjekjen e programeve të formimit vazhdues, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës mbulohen me fonde nga buxheti i parashikuar për këtë qëllim të Shkollës së Magjistraturës, si dhe nga burime të tjera financiare, të paracaktuara për këto veprimtari. Prokurori paraqet në Sektorin e Shërbimeve pranë Shkollës së Magjistraturës dokumentacionin përkatës, përfshirë këtu kërkesën për rimbursim të shpenzimeve të shoqëruar me ftesën për pjesëmarrje në trajnim, autorizimin e lëshuar nga drejtuesi i Prokurorisë, urdhrin e shërbimit të Zyrës së Financës pranë prokurorisë përkatëse dhe, sipas rastit, ndonjë dokumentacion tjetër provues sipas kërkesave të Shkollës së Magjistraturës. Njësia e Trajnimit kujdeset për të informuar prokurorët lidhur me dokumentacionin e nevojshëm.

2. Këshilli mund të mbulojë nga buxheti i vet shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për ndjekjen e trajnimeve të organizuara nga çdo institucion apo organizatë trajnimi, të njohur nga Këshilli, nëse këto shpenzime nuk mbulohen nga organizatori.

3. Për qëllime të zbatimit të pikës 2 të këtij neni, në propozimin e buxhetit vjetor drejtuar Kuvendit, Këshilli duhet të kërkojë financim të veçantë për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

KREU IV

PROKURORI NË PROGRAMIN E FORMIMIT VAZHDUES SI EKSPERT, MODERATOR DHE LEHTËSUES

Neni 10

Aktivizimi i prokurorit si ekspert, lehtësues dhe moderator

Prokurori mund të angazhohet si ekspert, lehtësues dhe moderator në trajnimet që përmban programi i formimit vazhdues që realizohen nga Shkolla e Magjistraturës apo institucione dhe organizata ndërkombëtare trajnimi, të njohura nga Këshilli, brenda apo jashtë vendit.

Neni 11

Përlllogaritja e ditëve të angazhimit si ekspert, lehtësues dhe moderator

1. Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në trajnimet e programit të formimit vazhdues sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, përlllogaritja e ditëve të prokurorit të angazhuar si ekspert, lehtësues dhe moderator do të bëhet, si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrjeje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrjeje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrjeje në trajnim.

2. Ky kontribut vlen vetëm për përlogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në formimin vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.

Neni 12

Përlogaritja e ditëve të angazhimit në trajnimet ndërkombëtare apo kombëtare

1. Kur Këshilli miraton pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime me natyrë profesionale, si pjesë e formimit vazhdues, kur këto trajnime organizohen nga institucione dhe organizata ndërkombëtare trajnimi, brenda apo jashtë vendit, përlogaritja e ditëve të prokurorit të angazhuar si ekspert, lehtësues apo moderator në këto aktivitete do të bëhet si më poshtë:

- një ditë pjesëmarrje në trajnime të organizuara në vendet e Bashkimit Evropian apo SHBA si ekspert, lehtësues apo moderator është e barabartë me 4 ditë pjesëmarrje në trajnim;

- një ditë pjesëmarrje në trajnime të organizuara në vendet të tjera që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian si ekspert, lehtësues apo moderator është e barabartë me 3 ditë pjesëmarrje në trajnim.

2. Pjesëmarrja në trajnimet e mësipërme dokumentohet nga prokurori pjesëmarrës përmes paraqitjes të Njësia Mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë, të dokumentacionit përkatës, si, ftesa për pjesëmarrje, agjenda e aktivitetit, materiali i prezantuar, certifikatë dhe çdo dokument tjetër që vërteton angazhimin e mësipërm.

3. Me paraqitjen e dokumentacionit të mësipërm, Njësia e Trajnimit përditëson regjistrat e trajnimeve të kryera nga/me Shkollën e Magjistraturës me ato të ofruara dhe certifikuara nga organizata të tjera kombëtare e ndërkombëtare të njohura nga Këshilli, me qëllim përmbushjen e detyrimit për të marrë pjesë në formimin vazhdues, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

DETYRAT ADMINISTRATIVE TË KËSHILLIT NË LIDHJE ME PROGRAMIN E FORMIMIT VAZHDI

Neni 13

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës

1. Këshilli bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës, e cila harton dhe organizon programin e formimit vazhdues për prokurorët, në përgatitjen e këtyre programeve.

2. Këshilli mund të propozojë tema të ndryshme trajnimi për t'u përfshirë në kalendarin me temat e trajnimeve për vitin akademik në vazhdim që përgatit Shkolla e Magjistraturës, si pjesë e programit të formimit vazhdues.

3. Komisioni kërkon propozime nga komisionet e tjera të përhershme të Këshillit, Njësia e Mbështetjes së Komisioneve, Prokurori i Përgjithshëm duke vendosur edhe një afat për dërgimin e tyre.

4. Institucionet dhe organizatat e përcaktuara në nenin 2, shkronja "g", të kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të propozojnë tema specifike për trajnimin e prokurorëve, si pjesë e programit të formimit vazhdues të prokurorëve.

5. Pas administrimit të propozimeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, Komisioni vlerëson përshtatshmërinë e tyre në raport me nevojat për trajnim të përcaktuara në kurrikulën e Shkollës së Magjistraturës.

6. Pasi vlerësohen si të përshtatshme, propozimi i Komisionit miratohet nga Këshilli dhe i dërgohet Shkollës së Magjistraturës për t'u pasur parasysh gjatë hartimit të programit të formimit vazhdues të vitit akademik në vazhdim.

Neni 14

Strukturat përgjegjëse të Këshillit lidhur me formimin vazhdues

1. Strukturat përgjegjëse të Këshillit që ndjekin procesin e formimit vazhdues të prokurorëve janë Komisioni dhe Njësia Mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë.

2. Komisioni është përgjegjës, për:

a) shqyrtimin e listës emërore të prokurorëve që duhet të marrin pjesë në programin e formimit vazhdues;

b) vlerësimin e përshtatshmërisë së kërkesave dhe propozimeve për zhvillimin e trajnimeve të formimit vazhdues;

c) përgatitjen e materialeve të nevojshme për t'u shqyrtuar nga Këshilli në mbledhje plenare;

d) çdo detyrë tjetër që lidhet me realizimin e programit të formimit vazhdues.

3. Njësia Mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë është përgjegjëse, për:

a) krijimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë nga ana e Komisionit apo komisioneve të tjera të Këshillit, për detyra që lidhen me pjesëmarrjen e prokurorëve në programin e formimit vazhdues;

b) dokumentimin e pjesëmarrjes së prokurorëve në programin e formimit vazhdues si pjesëmarrës apo si ekspert, moderator dhe lehtësues përmes administrimit të dokumentacionit përkatës;

c) komunikimin me Shkollën e Magjistraturës, institucionet e trajnimit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli dhe me çdo institucion tjetër lidhet me zbatimin e programit të formimit vazhdues;

d) administron regjistrat e trajnimeve ku të përfshihen ato të kryera me Shkollën e Magjistraturës dhe ato të ofruara dhe certifikuara nga organizata të tjera kombëtare ose ndërkombëtare;

e) harton, planifikon dhe kujdeset për zbatimin e programeve plotësuese të trajnimit për prokurorët dhe ndjek zbatimin e tyre në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Prokurorinë e Përgjithshme;

f) çdo detyrë tjetër që lidhet me realizimin e programit të formimit vazhdues.

Neni 15

Monitorimi dhe raportimi

1. Këshilli, në fund të çdo viti kalendarik kërkon informacion nga prokurori i përgjithshëm, në lidhje me efektivitetin e trajnimeve të kryera. Informacion, gjithashtu, kërkohet edhe nga Shkolla e Magjistraturës, në lidhje me vlerësimet e dhëna nga prokurorët pas përfundimit të trajnimit, në lidhje me këtë të fundit.

2. Mbi bazën e këtij informacioni, në vazhdimësi, strukturat e Këshillit marrin masa për përcaktimin e nevojave dhe përmirësimin e kurrikulave në të ardhmen.

3. Këshilli raporton çdo vit në lidhje me formimin vazhdues të prokurorëve në raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

Neni 16

Mospërbushja e detyrimit për të marrë pjesë në formimin vazhdues

1. Në fund të çdo muaji, Këshilli kërkon informacion nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnimet e programit të formimit vazhdues.

2. Mospërbushja pa shkaqe të pajustificuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj dhe në këtë Rregullore nga ana e prokurorit përbën shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË